



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATURA E SHTETIT  
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 1163/1 Prot.

Tiranë, më 29.03 2018

**Lënda :** Njoftim për shpalljen e pozicioneve vakante pranë Avokaturës së Shtetit

Në zbatim të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 «Për Avokaturën e Shtetit» të ndryshuar dhe Seksionit I të Kreut IV të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit, të miratuar me Urdhërin e Avokatit të Përgjithshëm nr.68, datë 28.03.2019, Avokatura e Shtetit, shpall procedurën e hapur konkurse për pozicionet e mëposhtme të punës:

**Në nivel qëndror:**

- Avokat Shteti pranë Zyrës së Këshillimit dhe Koordinimit Ndërministror- 3 pozicione vakante
- Avokat Shteti pranë Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe Arbitrazhin Ndërkombëtar- 1 pozicion vakantë
- Avokat Shteti pranë Zyrës së Inspektimit- 2 pozicione vakante

**Në nivel vendor:**

- Avokat Shteti pranë Zyrës Vendore Durrës- 1 pozicion vakant
- Avokat Shteti pranë Zyrës Vendore Gjirokastrë- 1 pozicion vakant
- Avokat Shteti pranë Zyrës Vendore Vlorë- 2 pozicione vakant

Sa më sipër, me anë të Urdhrit nr. 60, datë 26.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është miratuar rregullorja “Për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të procesit të rekrutimit, pranimit, periudhës së provës dhe emërimit të kandidatëve për pozicionin e avokatit të shtetit”, ndërsa me Urdhërin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr. 61, datë 26.03.2019, është miratuar programi “Për provimin fillestar të procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e avokatit të shtetit gjatë rregjimit ligjor kalimtar”.

Dorëzimi i dokumentave për aplikim do të bëhet pranë Avokaturës së Shtetit, në adresën: Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5, kati IV, deri në datën 23.04.2019.

*Janë të ftuar, që në zbatim të akteve të sipërcituara, të aplikojnë për t'iu nënshtruar procedurave të konkurimit të gjithë të interesuarit.*

Gjithashtu, ju njoftojmë se dy aktet e sipërcituara janë tashmë të publikuara edhe në faqen zyrtare të internetit të Avokaturës së Shtetit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHETIT**

**Artur METANI**

